

VENDIM
Nr. 238, datë 2.11.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMI I TË GJITHA OST-ve PËR NJË METODOLOGJI TË MODELIT TË PËRBASHKËT TË RRJETIT, NË PËRPUTHJE ME NENET 67 (1) DHE 70 (1), TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, ‘PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “f” dhe të nenit 26, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 7136 prot., datë 15.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim, “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike””.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht nenet 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht nenit 117, “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 25 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti vjen nga OST sh.a. në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë””, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 20.8.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit, në lidhje me krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Dokumenti i përbërë nga 25 nene saktëson mënyrën e krijimit të modeleve individuale të rrjetit nga secili OST, të dhënat që duhet të përmbajnë modelet përfshi topologjinë, ngarkesën, gjenerimin, si dhe mënyrën e bashkimit të këtyre modeleve në një të vetëm, nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë, me qëllimin përcaktimin dhe eliminimin e kongestionëve, për operimin optimal të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, dokumenti përcakton krijimin e një mjedisi të të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, i cili do të shërbejë si pikë referimi ku të gjitha OST-të do të jenë të detyruara të vënë në dispozicion dhe të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për krijimin e modeleve individuale të rrjetit.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit

Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator, duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, ‘Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike’” (bashkë-lidhur këtij vendimi).

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti